



This programme is funded  
by the European Union



## DEKLARATË

Tiranë, Tetor 2022

### **MBI ZBATIMIN E LIGJIT PËR NDIHMËN JURIDIKE TË GARANTUAR NGA SHTETI, PËR VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE DHE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE**

Aksesi në drejtësi është një ndër shtyllat themelore të luftës kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Miratimi në vitin 2017 i ligjit “Për ndihmën juridike të garantuar nga Shteti” e për afron kuadrin ligjor shqiptar me standardet ndërkombëtare, pasi krijon bazën për ngritjen e mekanizmave mbrojtës për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Përgjatë periudhës janar-dhjetor 2021, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare ndërmori monitorimin e zbatimit të ligjit në tri qarqe gjyqësore të vendit, përkatësisht Durrës, Shkodër dhe Tiranë, me qëllim analizimin e formave të ndihmës juridike të garantuar nga shteti: ofrimin e ndihmës juridike parësore, procesin për sigurimin e ndihmës juridike dytësore, procesin për përjashtimin nga të gjitha shpenzimet e procesit gjyqësor deri në ekzekutimin e vendimit të formës së prerë.

Në bazë të gjetjeve të monitorimit, konstatojmë se zbatimi në praktikë “Për ndihmën juridike të garantuar nga Shteti” mbetet ende i paplotë, prandaj tërheqim vëmendjen e institucioneve zbatuese të ligjit si vijon:

- **Domosdoshmëria e rishikimit të vendndodhjes së qendrës së shërbimit juridik falas të Tiranës**, sepse nga monitorimi është konstatuar: edhe pse Tirana është rrethi gjyqësor më i madh në vend, kjo qendër ka pasur numrin më të vogël të qytetarëve që kanë kërkuar ndihmë për vitin 2021, në raport me Shkodrën dhe Durrësin. Mendohet se një nga faktorët kryesorë për këtë, ka qenë vendndodhja e saj, prandaj sugjerohet që mjediset e kësaj qendre të zhvendosen nga Ministria e Drejtësisë drejt gjykatave të shkallës së parë, në përputhje me ndryshimet e hartës së re gjyqësore. Kjo zhvendosje do të shërbejë për të rritur aksesin e qytetarëve ndaj ndihmës ligjore falas.

- **Domosdoshmëria e rritjes së aksesit për viktimat e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje ndaj këtyre shërbimeve.** Drejtoria e Ndhmës Juridike pranë Ministrisë së Drejtësisë duhet të identifikojë edhe organizata të tjera të shoqërisë civile si dhe të autorizojë organizata e specializuara në rrethet gjyqësore, duke mbajtur parasysh edhe ndryshimet që do të vijnë me hartën e re gjyqësore, me qëllim përballimin e sfidave që mund të sjellë kjo e fundit në aksesin e qytetarëve.
- **Domosdoshmëria e përmirësimit të aksesit në mjediset e qendrave, organizatave dhe klinikave që ofrojnë ndihmë juridike parësore për personat me aftësi ndryshe.** Në linjë me këtë, raporti tërheq vëmendjen e klinikave universitare të ligjit që të përfshihen më shumë për ndihmën ligjore falas ndaj kategorive të veçanta në nevojë. Gjetjet e raportit dëshmojnë një përfshirje të papërfillshme të tyre në të gjitha rrethet e monitoruara.
- **Domosdoshmëria e përfaqësimit me avokat dhe forcimi i kapaciteteve profesionale të avokatëve që japin shërbim falas,** për realizimin e ndihmës parësore dhe dytësore për kategoritë e posaçme të viktimave të dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore.

Për njohje të mëtejshme të gjetjeve dhe rekomandimeve të raportit, lutemi [lexoni këtu](#).

Kjo Deklaratë u hartua në kuadër të projektit: “*Forcimi i rolit të Rrjetit të Monitorimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore*”, pjesë e projektit rajonal të UN Women<sup>1</sup> “**Fund dhunës ndaj grave në Ballkanin perëndimor dhe Turqi: Zbatojmë normat, ndryshojmë mendësitë**” i cili financohet nga Bashkimi Evropian.

---

<sup>1</sup> **Mohimi i përgjegjës:** Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e autorëve dhe kontribuesve dhe në asnjë rast nuk reflekton apo përfaqëson domosdoshmërisht mendimin apo qëndrimin e Komisionit Evropian dhe UN Women.